VENDIM
Nr.334, datë 18.4.2005

MBI LICENCËN
PËR RADIO VENDORE PRIVATE "STAR"

Në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 22 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T'i heqë subjektit juridik, shoqërisë "FKT" sh.p.k., licencën për radio vendore "STAR".
2. Licenca nr.056/FML bëhet e pavlefshme.
3. T'i japë subjektit, shoqërisë "STAR" sh.p.k., me vendndodhje në qytetin e Fierit, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik vendor privat, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
4. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj